



i madh dhe i sigurt

 Rruga "Jul VARIBOBA", Nr. 21, Tirana - Albania

 +355 4 223 838

 +355 42 400 800

 info@insig.com.al

INSIG SH.A

**PASQYRAT FINANCIARIE
VITI 2019**

INSIG sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

PËRMBAJTJA:

	FAQE
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E FITIM OSË HUMBJES DHE TE ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRESE	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITALIN NETO	5
PASQYRA E FLUKSIT TE PARASE	6
SHENIMET SHPJEGUESE PER PASQYRAT FINANCIARE PER QELLINE TE VECANTA	7-27

INSIG sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Pozicionit Financiar (Bilanci) Viti 2019

Aktivët	Skenime	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Mjetë monetare dhe ekuivalente në nj.monetare	5	5.882.846	18.165.213
Depozita me afat në Banka	6	473.832.055	373.197.000
Bono Thesari	7	0	0
Llogari të Arketueshme për prime	13	233.168.063	53.366.258
Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra (DAC)		160.663.722	179.086.073
Asete të risigurimit	9	200.763.646	303.633.059
Llogari të arketueshme nga veprimtaria e risiguar	10	0	0
Tatim fitimi i parapaguar		9.262.978	62.244
Aktivët afatgjatë materiale, neto.	11	517.980.660	504.155.697
Aktivët afatgjatë jomateriale, neto.	12	5.155.084	3.917.372
Aktive të tjera	13.1	1.332.188.352	937.829.109
Marrëdhënie me INSIG Maqedoni		0	128.592.888
Marrëdhënie me degën e INSIG Kosovë		0	0
Investim në INSIG Maqedoni	8	0	380.245.000
Totali i Aktiveve		2.938.897.406	2.882.249.914
Pasivët			
Provizione për Dertë	14	871.988.997	948.659.548
Provizione për Primin e Pafitur	15	565.893.040	510.224.108
Llogari të pagueshme për risiguresit	16	8.912.351	10.252.672
Taksa të pagueshme (tatim fitimi)		17.878.934	0
Llogari të tjera të pagueshme	17	242.619.901	279.176.382
Provizione të tjera	18	15.072.697	360.860
Marrëdhënie me INSIG Maqedoni		0	0
Marrëdhënie me degën e INSIG Kosovë		-1.332.728.380	518.612.525
Detyrim tatimor i shtyrë	30	2.333.155	2.333.155
Totali i Detyrimeve		391.970.695	2.269.619.250
Kapitali i Nenshkruar	19	650.000.000	650.000.000
Rezerva rivlerësimi	20	279.684.643	279.684.643
Rezerva për parandalimin e detyrës	21	44.677.559	44.677.559
Rezerva të tjera	22	1.050.611.336	1.050.611.336
Rezerva konvertimi	23	8.828.000	8.828.000
Fitime / Humbje të akumuluar		429.609.461	(1.389.545.011)
Fitime / Humbje e vitit financiar, Dega Kosovë	32	-	(63.986.313)
Fitime / Humbje e vitit financiar, Shqipëria	2	83.515.712	32.360.451
Totali i kapitaleve të veta		2.546.926.711	612.630.665
Totali i Pasivët		2.938.897.406	2.882.249.914

Gëzim TOLO

DREJTOR I PËRCJELLJESHEM



INSIG sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

Pasqyra e Fitim ose Humbjes dhe të Ardhurave Gjithëpërfshirëse Viti 2019

		31.12.2019	31.12.2018
	Shenime	Shqiperi	Shqiperi
Prime të shkruara bruto	24	1.129.175.075	1.093.464.534
Ndryshimi në provizionin e primeve të pafituara bruto (+/-)	15,1	-55.668.933	41.428.432
Prime të shkruara neto		1.073.506.142	1.134.892.966
Prime të ceduara në risigurim (-)	25	-65.841.940	-71.191.078
Ndryshimi në provizionin e primeve të pafituara, pjesa e risiguruesve (+/-)	15,1	1.452.117	-5.224.267
Prime të fituara neto		1.009.116.319	1.058.477.621
Te ardhura të tjera të aktivitetit	27	11.085.767	11.672.606
Shpenzime për dëme , neto	14	-278.034.003	-293.311.476
Shpenzime të marrjes në sigurim si dhe ndryshimi i DAC	28	-327.854.264	-309.974.857
Shpenzime administrative	29	-267.723.616	-278.496.530
Shpenzime reklame, marketingu	29,1	0	-8.154.403
Shpenzime të tjera të aktivitetit	29,2	-61.645.723	-111.325.105
Operating Profit/(loss)		84.942.479	68.887.855
Te ardhura nga investimet	26	33.875.158	5.323.329
Fitime / humbje nga kurset e këmbimit (+/-)	26	-17.422.991	-33.809.611
Te ardhura financiare neto		16.452.167	-28.486.282
Fitimi përpara taksimit:		101.394.646	40.401.573
Tatim fitimi	31	-17.878.934	-8.041.123
Fitimi neto i vitit	2	83.515.712	32.360.451

Pasqyra përmblledhëse e të ardhurave duhet të lexohet në tërësi me shënimet shpjeguese.

Gëzim TOLA

DREJTORI PËRGJITHSHËM



Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Te gjitha shumat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

EMERITIMI	Kapitali aksionar	Rezerva rivlerësimi	Rezerva për paraqindimisin e dëmeve	Rezerva të tjera	Rezerva e konvertimit	Fritime/humbje të akumuluarra	Fritime/humbje të ushtrimit	Totali
pozicioni më 1 Janar 2018	650,000,000	171,647,635	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	-1,540,253,117		385,511,413
Zvogëlim i Rezervës së rivlerësimit për asetet e shtrita		-18,912,340						-18,912,340
Shese rezervë rivlerësimi për ndërtimet e rivlerësuar		126,949,348						126,949,348
Tanimi fitimi i dëdhur për vitet me humbje 2012, 2013 (njohur nga tatimet)								0
Zvogëlim i fitimeve të akumuluarra për aktivitetin e jo jetës Humbja neto për periudhën: INSIG Shqipëri Humbja neto për periudhën: Dajta Kosovë						150,708,105		150,708,105
							32,360,451	32,360,451
							-63,986,313	-63,986,313
								0
Pozicioni më 31 Dhjetor 2018	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	-1,389,545,012	-31,625,862	612,630,663
pozicioni më 1 Janar 2019	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	-1,421,170,874		612,630,663
Zvogëlim i Rezervës së rivlerësimit për asetet e shtrita								0
Shese rezervë rivlerësimi për ndërtimet e rivlerësuar								0
Tanimi fitimi i dëdhur për vitet me humbje 2012, 2013 (njohur nga tatimet)								0
Zvogëlim i fitimeve të akumuluarra për aktivitetin e jo jetës Humbja neto për periudhën: INSIG Shqipëri Humbja neto për periudhën: Dajta Kosovë						1,850,780,335		1,850,780,335
							83,515,712	83,515,712
								0
								0
Pozicioni më 31 Dhjetor 2019	650,000,000	279,684,643	44,677,559	1,050,611,336	8,828,000	429,609,461	83,515,712	2,546,926,711

Pasqyra e Ndryshimit të Kapitalit duhet të lexohet në tërësi me shënime të shpjegueshë të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.



Pasqyra e Flukseve të Parase (metoda indirekte)

	2019	2018
Flukset e arkes nga aktiviteti operativ		
Fitimi pas tatimit	83.515.712	32.360.451
<i>Ashustime per :</i>		
Interesa nga investimet financiare	-10.992.158	-5.323.329
Amortizimi	-48.476.746	29.118.521
Humbje nga ndjerrjet jashte perdorimit te aktive fix	-1.197.584	1.927.022
Efekte nga konvertimi	0	0
Rritje/ulje ne cash per njesi kontrolluese	-128.592.888	-92.626.872
Rritje/ulje ne asetet e risiguruesit	102.869.413	-82.207.895
Rritje/ulje ne llogaritë e arketueshme nga risiguroesi	0	0
Rritje/ulje ne llogaritë e arketueshme per primet	-179.801.805	-6.864.998
Rritje/ulje per kostot e shtyra te marrjes ne sig (DAC)	18.422.351	35.670.194
Ndryshime ne taksat e parapaguara,tatim fitimi	-27.079.668	28.879.312
Rritje/ulje per rezervat teknike te dëmeve	-76.670.351	114.341.727
Rritje/ulje per rezervat teknike te primeve	55.668.932	-41.428.432
Rritje/ulje ne detyrimet e tjera	37.014.592	-122.277.639
Rritje/ulje ne taksat e shtyra	0	3.318.959
Rritje/ulje ne aktivet e tjera	-453.218.479	226.543.171
Rritje/ulje ne llogaritë te pagueshme per risiguroesin	1.340.321	9.366.294
Interesa te arketuara	10.992.158	5.323.329
Flukset e arkes gjeneruar nga aktiviteti operativ	-519.252.909	136.119.816
Flukset e arkes nga aktiviteti investues		
Blerje aktivesh te qendrueshme te trapezuara	-42.471.279	-133.054.647
Rritje/ulje nga investimet ne depozita	-100.635.055	6.573.000
Blerje/maturim ne bono thesari	650.076.875	0
Divident i paguar		
Fluksi i arkes nga aktiviteti investues	506.970.541	-126.481.647
Fluksi i arkes i gjeneruar	-12.282.368	9.638.169
Mjete monetare ne arke dhe banke ne fillim te periudhes	18.165.213	8.527.044
Mjete monetare ne arke dhe banke ne fund te periudhes	5.882.845	18.165.213

Pasqyra e Rrejdhes së Parase duhet të lexohet në tërësi me shënimet shoqëruese, të cilat janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

INSIG sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)

SHËNIMET SHPJEGUESE PËR PASQYRAT FINANICARE PËR QELLIME TË VECANTA

1. TË PËRGJITHSHME

INSIG Sh.a. ("Shoqëria") është themeluar në vitin 1991 si një kompani sigurimi 100% në pronësi të Qeverisë së Shqipërisë, e përfaqësuar nga Ministria e Financave deri në datën 13/07/2015 dhe pas kësaj date nga aksioneri Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizimit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes. Në datën 30.06.2016 pas përfundimit të privatizimit të shoqërisë aksioner i vetëm është EUROSIG sh.a. Aktiviteti kryesor i biznesit të saj përfshin shërbimet e sigurimit për mjetet motorrike, pronë, marinë dhe lloje të tjera sigurimi. Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2019 përfshijnë Shoqërinë dhe Degët/Zyrat e perfaqesimit të saj. Selia qendrore e INSIG sh.a. është në adresën: Rruga Jul Variboba, Nr.21, Tiranë.

Më 1 Mars 2000 Shoqëria çeli një degë në Kosovë ("Dega"). Kjo degë ofron kryesisht sigurime të mjeteve motorrike dhe sigurim i palëve të treta në të gjithë territorin e Kosovës.

Gjatë vitit 2004, Ministria e Financës i transferoi 19.5% ose 332 aksione të INSIG Sh.a Korporatës Financiare Ndërkombëtare ("IFC") dhe 19.5% ose 332 aksione Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim ("EBRD"). Transferimi i fondeve është kryer me miratim të Gjykatës së Tiranës, vendimi Nr. 21463/6, datë 30 Qershor 2004.

Në përputhje me Marrëveshjen e Opsioneve të Vendosijes e nënshkruar më 28 Tetor 2003, neni 7, IFC dhe BERZH kanë dorëzuar më 29 Dhjetor 2008 Ministrisë së Financës shitjen e aksioneve respektive dhe blerjen e tyre nga Ministria e Financës.

Ministria e Financës, në përputhje me marrëveshjen e përmendur më sipër i ka paguar IFC dhe BERZH për aksionet e tyre përkatëse më 10 Mars 2009. Në përputhje me Ligjin Nr. 9723 i datës 3 Maj 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit" shoqëria ka kryer rregjistrimet e nevojshme për të pasqyruar transaksionin e mësipërm.

Më 25 Gusht 2009 Bordi Drejtues vendosi të zvoglojë vlerën nominale të aksioneve nga 1000 Lek për aksion në 600 Lek për aksion.

Më 30 Qershor 2016 Insig sh.a është privatizuar, duke u blerë 100% e aksioneve nga Eurosig sh.a.

Më 26 Prill 2019, në Kosovë, u shpall vendimi i BQK-së nr. 23-10/2019 për revokimin e licencës së Insig sh.a - Dega Kosovë, duke përcaktuar kështu edhe likuidatorin nga vetë BQK. Kjo çoi në shuarjen e detyrimeve të Insig sh.a Shqipëri për Degën Insig në Kosovë.

Më 31 Dhjetor 2019, INSIG SH.A. ka një staf total prej 137 personash si personel dhe nivel drejtues.



2. BAZA E PËRGATITJES

(a) BAZA E PËRPUTHSHMËRISË

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Në mungesë të udhëzimeve specifike të SNRF për trajtimin kontabël të transaksioneve që lidhen me sigurimet, Drejtuesit kanë marrë në konsideratë kërkesat dhe udhëzimet e Standarteve të Raportimit Financiar që lidhen me çështje të ngjashme; përkufizimet, kriteret për njohjen dhe matjen e aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve të trajtuara në "Kudrin e Përgjithshëm të SNRF-së", si dhe prononcimet e bordeve të tjera themeluese të standardeve, dhe praktika të pranueshme të industrisë, siç nënvizohet nga SNK 1.

(b) BAZA E PËRGATITJES

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, me përjashtim të aktiveve afatgjate materiale, të cilat janë rivlerësuar fillimisht më 31 Dhjetor 1997, me pas një pjese e tyre rivlerësuar në 31.12.2014, në 31.12.2017 dhe rivlerësimi i fundit për ndertesën kryesore të Drejtorisë Qendrore rivlerësuar me 30.09.2019.

(c) MONEDHA FUNKSIONALE DHE E PREZANTIMIT

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Lek, monedha Shqiptare, që është dhe monedha funksionale, përveç rasteve ku specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lek.

(d) PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtuesit e kompanisë të kryejnë vlerësime, gjykime dhe supozime të cilat do të ndikojnë në aplikimin e politikave dhe raportimin e shumave të aktiveve dhe detyrimeve, shpenzimeve e të ardhurave. Vlerësimet dhe supozimet bëhen mbi bazën e eksperiencës historike dhe faktorëve të tjerë të ndryshëm që në rrethana të caktuara janë të arsyeshëm, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi vlerat e mbartura të aktiveve dhe detyrimeve të cilat nuk janë lehtësisht të identifikueshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve.

Vlerësimet dhe supozimet e lidhura me to, rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet në vlerësimet kontabël njihen në periudhën kur vlerësimi është rishikuar në rastin, kur rishikimi ka ndikim vetëm në atë periudhë; ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme, në rastin kur rishikimi ndikon periudhën aktuale dhe ato të ardhshme.

Politikat kontabël janë të njëjta me ato të përdorura në vitet e mëparshme dhe janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL

(a) MONEDHA E HUAJ

(i) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj janë ato transaksione të cilat kryhen në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale. Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në atë funksionale sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetarë në monedhë të huaj konvertohen



sipas normës së këmbimit në datën e raportimit. Diferencat e lindura nga konvertimi paraqiten në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj, të deklaruar me kosto historike konvertohen sipas normës së këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj të cilat janë të deklaruar me vlerën e drejtë konvertohen në Lek sipas kursit të këmbimit të datës në të cilën vlera e drejtë është përcaktuar.

- aktivët dhe detyrimet konvertohen me kursin e këmbimit në datën e bilancit;
- të ardhurat e shpenzimet konvertohen me kursin e këmbimit të përafërt me kursin e këmbimit që përkon me datën e transaksionit.

Monedhat e huaja me të cilat kryesisht veprohet janë: Euro (EUR), US Dollar (USD), Pound Britanik (GBP). Kurset e këmbimit të përdorura për konvertim më 31 Dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31.12.2019	31.12.2018
1 EUR/LEK	121.77	123.42
1 USD/LEK	108.64	107.82
1 GBP/LEK	143	137.42

4. KLASIFIKIMI I KONTRATAVE TË SIGURIMIT DHE INVESTIMIT

Kontratat nëpërmjet të cilave kompania pranon të mbajë një risk sigurimi të konsiderueshëm nga një palë tjetër (policë mbajtësi) duke kompensuar policë mbajtësin kundrejt një ngjarje të ardhshme të specifikuar e të pasigurtë (ngjarja e sigurimit) e cila ndikon negativisht mbi policëmbajtësin, klasifikohen si kontrate sigurimi. Çdo risk që nuk është risk financiar konsiderohet si risk sigurimi. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të ardhshëm të mundshëm të një ose më shumë se një norme interesi të veçantë, ndryshimi i çmimit të letrave me vlerë, çmimit të borxhit, kursit të këmbimit, indekse çmimesh ose normash, indeksit ose variablave të tjerë të kreditimit, me kusht që në rastin e një variabli jo-financiar ky variabli nuk është specifik për asnjë prej palëve të një kontrate.

Kontratat nëpërmjet të cilave transferimi i rrezikut të sigurimit kryhet nga policë mbajtësi tek shoqëria dhe kur ky risk nuk është i konsiderueshëm, klasifikohen si kontrata investimi. Të gjitha kontratat aktuale të nënshkruara nga shoqëria përfshijnë transferimin e një rreziku të konsiderueshëm sigurimi.

(b) KONTRATA E SIGURIMIT

(i) Njohja dhe matja

Kontratat e përgjithshme të sigurimit

Rezervat teknike janë përlogaritur më vete për të gjitha produktet e sigurimit dhe përbëhen nga primet e mundshme (të pa fituara), risqet e mundshme (të pamaturuar) dhe dëmet e mundshme (të papaguar në ditën e mbylljes së vitit financiar). Rezervat teknike (provigjionet) përfshijnë parashikime për pagesat të ardhshme të dëmeve të deklaruar dhe të padeklaruar. Shoqëria nuk ka konton rezervat e tij

teknike. Çdo ndryshim në parashikim paraqitet në rezultatet e operacioneve në periudhën kur janë ndryshuar parashikimet. Parashikimi i detyrimeve të sigurimit është një proces kompleks që ka të bëjë me pasiguri dhe që kërkon përdorimin e gjykimeve dhe parashikimeve jo formale. Shoqëria i është përmbajtur kërkesave të rregullatorëve ose mbikqyrësve të segmentit sigurues për të llogaritur rezervat përkatëse teknike.

Të ardhurat

Primet e shkruara bruto nga kontratat e sigurimit perfaqesojnë shitjet gjatë vitit dhe nuk përfshijnë detyrimet tatimore ose detyrime të tjera mbi primet.

Në të ardhurat e shoqërisë njihet pjesa e fituar e primeve të shkruara bruto nga data e fillimit të kontratës së sigurimit deri në datën e raportimit. Primi i pafituar është primi që i përket periudhës nga data e raportimit deri në datën e përfundimit të kontratës së sigurimit. Primi i pafituar njihet si pakësim i të ardhurave nga primet e shkruara bruto dhe llogaritet në baze të metodës prorata temporis.

Rezerva për primin e pafituar

Rezerva e primin të pafituar në të gjitha segmentet e biznesit perbehet nga pjesa e primin të shkruar bruto e cila pritet të fitohet në vitin pasardhës e llogaritur në baze të metodës pro rata temporis e rregulluar nëse nevojitet në mënyrë që të reflektojë çdo ndryshim të ndodhjes së rrezikut gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata e sigurimit.

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë pjesa e kostove të marrjes në sigurim të cilat i takojnë primeve pas datës së raportimit; ato lidhen me periudhën midis fundit të periudhës së raportimit dhe datës së shuarjes së kontratës së sigurimit.

Dëmet të krijuara nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura dhe të raportuara (RBNS) përbëhen nga kostot e mbylljes dhe trajtimit të dëmeve të paguara dhe të papaguara që lindin nga ngjarje të ndodhura gjatë vitit financiar së bashku me rregullime të provigjionit të dëmeve të vitit të mëparshëm. Dëmet e papaguara vlerësohen duke rishikuar dëmet individuale dhe Provigjioni për dëmet e papaguara nuk skontohet. Rregullimet për provigjionin e dëmeve të viteve të mëparshme reflektohen në pasqyrat financiare të periudhës në të cilën bëhen rregullimet dhe paraqiten më vete nëse janë materiale.

Dëmet e ndodhura por të paraportuara (IBNR) provigjionohen duke u bazuar në metodat aktuariale të njohura dhe të pranuara.

Dëmet e ndodhura por të paraportuara janë njohur vetëm për linjat motorike të biznesit dhe jo për linjat të tjera jo motorike, duke qenë se ka informacion të paplote dhe eksperiencë tregon që pretendimet raportohen më shpejtë në linja të tilla.



Angazhimet për dëmet në proces gjyqësor

Një pjesë e konsiderueshme e dëmeve janë në proces gjyqësor dhe për të cilat shoqëria ka regjistruar detyrimin përkatës në bazë të vlerësimeve të drejtimit.

Rezerva për rrezikun e paskaduar

Rezerva për rrezikun e paskaduar krijohet atëherë kur vlera e pritshme e dëmit dhe e shpenzimeve që e shoqërojnë atë i atribuohet periudhave të paskaduara të policave në fuqi në datën e bilancit, tejkalon provigjionin e primeve të pafituara të lidhura me polica të tilla.

Risigurimi

Shoqëria cedon primet e siguruara dhe rrezikun në rrjedhën normale të biznesit me potencialin e humbjes neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut që krijohet nga linjat e biznesit të MTPL, pasurisë, kartoni jeshil, pergjegjesite dhe aksidentet personale.

Risigurime të tilla përfshijnë tejkalimin e humbjeve nga marrëveshjet fakultative. Vetëm kontratat që përfshijnë transferimin e një pjese të konsiderueshme të rrezikut të sigurimit dhe atij kohor regjistrohen si aktive të sigurimit. Marrëveshjet e risigurimit nuk e çlirojnë shoqërinë nga detyrimet direkte ndaj policë-mbajtësit. Detyrimet e risigurimit përfshijnë llogari të pagueshme për kontrata të jashtëme risigurimi dhe njihen si shpenzime kur u mbaron afati.

Primet e ceduara në risigurim njihen si pakesim i te ardhurave nga primet në mënyrë që të jenë konsistente me njohjen e primeve të lidhura me kontratat e sigurimit. Për sigurimin e përgjithshëm të biznesit, primet e risigurimit shpenzohen në periudhën në të cilën mbulimi i risigurimit jepet në bazë të modeleve të rrezikut të risiguar. Pjesa e pashpenzuar e primit të risigurimit të ceduar përfshihet në aktivet e risigurimit. Shuma e njohur si aktiv i risiguar matet në mënyrë që të jetë konsistente me matjet e provigjionit të mbajtur në përputhje me kontratat e sigurimit.

Llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi përfshijnë komisionet e risigurimit nga primet e ceduara risiguruesit dhe të arkëtueshmet nga Shoqëria risiguruese në përputhje me dëmin e paguar. Këto janë klasifikuar si llogari të arkëtueshme dhe paraqiten të vecanta, nëse ka.

Aktivët e risigurimit vlerësohen për zhvlerësim në datën e raportimit. Një aktiv konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka evidencë objektive, si rezultat i një ngjarje të ndodhur pas njohjes fillestare, që Shoqëria mund të mos marrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt besueshmërisht të matshëm në shumat që Shoqëria do të marrë.

Llogaritë e arkëtueshme dhe të pagueshme të sigurimit

Shumat nga dhe kundrejt policëmbajtësve, agjentëve dhe risiguruesve janë instrumenta financiare dhe janë përfshirë në Llogaritë e pagueshme ose të arkëtueshme të sigurimit dhe jo në rezervat teknike ose aktivet e risigurimit.

(c) MJETET MONETARE NË ARKË DHE EKVIVALENTË

Mjetet monetare në arkë dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj që nga momenti i blerjes.



(d) LETRA ME VLERË

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat kompania ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim.

(e) DEPOZITAT ME AFAT

Klasifikohen si investime në depozita ato me maturitet midis tre dhe dymbëdhjetë muaj.

Depozitat me afat paraqiten në bilanc me shumën e principalit të tyre të pashlyer dhe klasifikohen sipas maturitetit. Llogaritë e tjera të arkëtueshme paraqiten me kosto minus humbjet nga rënia në vlerë.

(f) AKTIVET AFATGJATA JO MATERIALE

Aktivitet Afatgjata Jo Materiale perfaqesojne programe dhe licensa informatike te blera nga shoqeria. Ato paraqiten me koston e tyre të blerjes te pakesuara me amortizimin e llogaritur.

Amortizimi

Amortizimi i Aktive Afatgjata JoMateriale llogaritet duke përdorur metodën e amortizimit zbritës të llogaritur mbi vlerën e mbetur të aktivit. Norma vjetore e amortizimit është 25 % (2015 :25%).

(g) AKTIVET AFATGJATA MATERIALE

Aktivitet Afatgjata Materiale paraqiten me koston e tyre të blerjes, pakesuar me amortizimin e llogaritur. Aktivitet afatgjata të blera përpara datës 31 Dhjetor 1997 mbahen me vlerën e rivlerësimit në 31 Dhjetor 1997. Metodologjia është aplikuar për të rritur koston dhe amortizimin e akumuluar me koeficientë që varionin nga 1.1 në 16.3. Teprica rezultuese nga rivlerësimi kreditohej direkt në kapital. Ne raste se pjesë të Aktiveve Afatgjata Materiale kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato llogariten si pjesë të veçanta të Aktiveve Afatgjata Materiale.

Ne vitin 2014 dhe 2017 shoqeria ka evidentuar rivleresim te nje pjese te ndertimeve dhe trojeve duke rritur vleren e tyre si dhe rezerven perkatese te rivleresimit. Gjithashtu ne vitin 2017 dhe 2019 eshte bere shitja e nje pjese te ndertesave dhe pjese e mbetur eshte rivleresuar nga ekspert te vleresimit te pasurive te paluajtshme Gjate vitit 2018 shoqeria ka evidentuar rivleresim per ndertesën e drejtorise qendrore duke rritur vleren e saj si dhe rezerven perkatese te rivleresimit. Ndertesë është rivleresuar ne rritje me 30.09.2018 per 126,949,548 Leke.

Amortizimi

Amortizimi i Aktive Afatgjata Materiale llogaritet duke përdorur metodën e amortizimit zbritës të llogaritur mbi vlerën e mbetur të aktivit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen. Për vitin 2019 është aplikuar edhe SNRF 16 për Qiratë. Standart ky që kërkon për llogaritje Amortizimi për çdo kontratë qiraje. Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

Kategoria	2019	2018
Ndërtesat dhe përmirësimet në infrastrukturë	5 %	5 %
Makinëri dhe pajisje	20 %	20 %
Pajisje zyre	25 %	25 %
Mjete motorrike	20 %	20 %
Mobilje	20 %	20 %



(h) PROVIGJIONET

Një provigjion njihet në bilanc kur kompania ka një detyrim aktual ligjor ose përfitues si rezultat i një ngjarje të shkuar dhe është e mundur që një fluks dalës përfitimesh ekonomike të kërkohej për të zgjidhur detyrimin.

(i) NJOHJA E TË ARDHURAVE FINANCIARE

Të ardhurat nga investimet përfaqësojnë të ardhura nga aktivet financiare dhe njihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të të ardhurave me metodën e interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma e aktualizimit që barazon flukset që vlerësohen të arkëtohen në të ardhmen përgjatë jetëgjatësisë së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose për një periudhë më të shkurtër kur kjo është e përshtatshme) me vlerën e mbartur të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset kur aktiviteti ose detyrimi financiar njihet fillimisht në pasqyra financiare dhe nuk rishikohet në mënyrë të vazhdueshme.

(j) SHPENZIMET

(i) Pagesat e qerasë operative

Pagesat e bëra për qerantë operative njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën lineare përgjatë periudhës së qerasë. Nxitësit e qerasë të përfituar njihen në pasqyrë si pjesë integrale e shpenzimit total të qerasë. Prej 31.12.2019 për qeratë është zbatuar SNRF 16, duke llogaritur amortizimin dhe interesin për periudhën e qerasë, si pjesë përbërëse e kësteve mujore të specifikuara në secilin kontratë qiraje.

(i) kontributet shoqërore të detyrueshme

Kompania paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore dhe shendetësore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni, kur këta të fundit dalin në pension.

(ii) Leja vjetore e paguar

Shoqëria njihet si detyrim shumë e pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritët të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar.

(k) SHPENZIMET E MARRJES NË SIGURIM

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë edhe kostot direkte, të tilla si komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative që lidhen me procesin e propozimit dhe emetimit të policave.

(l) TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin apo humbjen për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital, rast në të cilin ai njihet në kapital.



5. MJETET MONETARE DHE EKVIVALENTË

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen si më poshtë:

	Më 31.12.2019	Më 31.12.2018
Mjetet monetare në bankë, në monedhë të huaj	4.352.927	10.212.943
Mjetet monetare në bankë, në Lek	1.500.871	7.922.991
Arka në leke dhe në monedhe të huaj	29.048	29.279
Totali	5.882.846	18.165.212

6. DEPOZITA ME AFAT

Klasifikimi i depozitave me afat maturimi më të madh se tre muaj, por jo më pak se një vit sipas monedhave.

Fitimet e përcaktuara nga kursi i këmbimit që vijnë nga rivlerësimi i depozitave me afat në monedha të huaja me kursin e këmbimit të datës së raportimit janë përfshirë në zërin "Fitime nga kursi i këmbimit" në pasqyrën e të ardhurave. Ndryshimi i pronësise së shoqërisë solli edhe ndryshimin e politikave të pronarit të ri mbi investimet financiare.

	Më 31 Dhjetor 2019		Më 31 Dhjetor 2018	
	Shuma	% Interesit	Shuma	% Interesit
EUR	118.832.055	0,001	43.197.000	0,3
USD				
GBP				
ALL	355.000.000	1,9	330.000.000	1,6
Totali	473.832.055		373.197.000	

7. INSTRUMENTA BORXHI TË MBAJTURA DERI NË MATURIM

Për periudhën e mbyllur më 31.12.2018 si dhe 31.12.2019 shoqëria INSIG sha nuk rezulton të ketë investuar në instrumenta të tjerë borxhi.



INSIG sh.a.

Shënime për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

(Të gjitha shumat janë shprehur në LEK, përveç kur shprehet ndryshe)



8. INVESTIME NE PJESEMARRJE

Në vitin 2004 INSIG sh.a. Shqipëri investoi për të filluar aktivitetin në territorin e Republikës së Maqedonisë nëpërmjet filialit INSIG Makedonia.

	Më 31.12.2019	Më 31.12.2018
Investimi ne Maqedoni	0	380,245,000

Sipas legjislacionit Maqedonas shuma e investuar si kapital në monedhë origjinale është 3,000,000 Euro. Ky investim në pasqyrat financiare është i vlerësuar me kosto historike në momentin e krijimit të aktivitetit. Ndërkohë në 26.06.2019 referuar politikave të kompanisë këto aksione u shitën në 100% të tyre, duke u blerë nga kompania Maqedonase Grawe.

Ndërkohë nga marrëdhënia me degën e INSIG Kosovë gjatë vitit 2017 shoqëria INSIG-sha injektoi shtesë kapitali në vlerën 1,083,334 euro dhe gjatë vitit 2018 në vlerën 483,334 euro, e cila bazuar në Vendimet e Mbikëqyrësit BQK në Republikën e Kosovës dhe Planin e masave të miratuara nga BQK, 50% e humbjes së evidentuar në Pasqyrat Financiare të vitit 2016 për degën Kosovë përbëjnë detyrim të evidentuar në PF të shoqërisë Insig- Shqipëri dhe diferenca e humbjeve të mbartura të Insig- Dega Kosovë pritej të rikuperohet nga aktiviteti i shitjeve të vetë Degës për periudhë 3 vjeçare, 2017-2019. Referuar vendimit nr. 23-10/2019 të Bordit Ekzekutiv të BQK-së më 26 Prill 2019, u revokua licenca e Insig sh.a Dega Kosovë, duke emëruar dhe likuidatorin. Me emërimin e likuidatorit shuhen të gjitha përgjegjësitë për detyrimet dhe mbartjet nga Dega Insig Kosovë të pasqyruara në Pasqyrat Financiare të Insig Shqipëri, duke nxjerr në pah fitimet e akumuluar të kësaj të fundit.

9. ASETETË RISIGURIMEVE (PJESA E RISIGURUESIT NË REZERVAT TEKNIKE)

Në fund të vitit, pjesa e risiguruesit në rezervat teknike të kompanisë është si më poshtë:

	Më 31 Dhjetor 2019	Më 31 Dhjetor 2018
Provizione të primit të paguar, pjesa e risiguruesve	16.459.140	15.007.023
Provizione të dëmeve, pjesa e risiguruesve	184.304.505	288.626.036
Totali	200.763.646	303.633.059

10. LLOGARI TË ARKETUESHME NGA VEPRIMTARIA E RISIGURIMIT

Gjatë vitit 2019 shoqëria INSIG sha rezulton të ketë arketuar në kohë dhe brenda vitit, të gjitha të drejtat për rimbursim nga risiguruesi për dëme të ndodhura, të cilat kanë rezultuar në total në vlerën prej 41,532,879.14 lekë.

11. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE, neto

Kosto/Vlerësimi	Ndertesa & Vepra					Totali	
	Truall	infras,	Automjete	Mobilje	Pajisje zyre		Mjete kompjuterike
Gjendja më 1 janar 2019	37.440	517.059.736	35.740.691	14.872.104	23.153.624	26.393.195	617.256.790
Shtesa		14.380.300	27.507.794	50.780	122.500	409.905	42.471.279
Rivlerësim			(1.935.750)				(1.935.750)
Shitje/Transferime							
Pakesimi (nëqerje jashte përdorimit)							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	37.440	531.440.036	61.312.735	14.922.884	23.276.124	26.803.100	657.792.319
Zhvlerësimi i akumuluar							
Gjendja më 1 janar 2019	-	(48.955.210)	(12.699.317)	(12.561.005)	(21.363.305)	(17.522.256)	(113.101.094)
Shpenzimi për vitin		(16.410.872)	(7.974.854)	(466.288)	(357.745)	(2.238.968)	(27.448.726)
Shitje/Transferime			738.166				738.166
Pakesimi (nëqerje jashte përdorimit)							
Gjendja më 31 dhjetor 2019	-	(65.366.082)	(19.936.005)	(13.027.293)	(21.721.051)	(19.761.224)	(139.811.654)
Vlera e mbetur neto							
